



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Tiranë, më 26 Prill 2021

## RAPORT I NDËRMJETËM

### **Mbi disa gjetje dhe konkluzione paraprake nga vëzhgimi i disa aspekteve të procesit zgjedhor, në kuadër të Zgjedhjeve Parlamentare të dt. 25 Prill 2021**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është organizatë jofitimprurëse, misioni i të cilës është të kontribuojë për respektimin e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës, si dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë. Duke vlerësuar ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur si një të drejtë themelore kushtetuese, KShH ka monitoruar proceset zgjedhore të realizuara në vendin tonë që prej vitit 1996.

Për monitorimin e procesit zgjedhor të Zgjedhjeve Parlamentare 2021, KShH ka angazhuar 206 vëzhgues afatshkurtër dhe afatgjatë, të akredituar nga KQZ, në 14 Bashki të vendit, përkatësisht në: Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Fier, Shkodër, Malësi e Madhe, Dibër, Lezhë, Pogradec, Berat, Kukës, Gjirokastrë.

KShH, më datë 23 prill 2021 ka publikuar një raport të ndërmjetëm lidhur me aspekte të procesit parazgjedhor<sup>1</sup>, me fokus në reformën zgjedhore, ngritjen dhe veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQV), listat e zgjedhësve, votën e diasporës, fushatën zgjedhore dhe ndalimin e përdorimit të burimeve shtetërore, incidentet dhe denoncimet për shitblerjen e votës, integritetin e kandidatëve për deputet dhe dekriminalizimin, si dhe aspekte të ngritjes dhe funksionimit të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV).

Ky raport pasqyron disa prej gjetjeve dhe konkluzioneve paraprake nga vëzhgimi i procesit zgjedhor, procesit të votimit dhe numërimit, në 14 Bashkitë në fjalë.

Vëzhgimi është realizuar në kuadër të zbatimit të dy nismave, përkatësisht “Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen” mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian dhe "Drejt integritetit më të mirë të kandidatëve, për Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme”, mbështetur nga Republika Federale Gjermane.

**Në mënyrë të përmbledhur, nga monitorimi i disa aspekteve të rëndësishme të procesit para zgjedhor, ditës së votimit dhe numërimit rezulton se:**

- **Grupet e Numërimit të Votave (GNV)**

Ngritja e Grupeve të Numërimit të Votave (GNV) në disa raste është shoqëruar me problematika dhe vonesa, duke mos respektuar kërkesat e nenit 95 të Kodit Zgjedhor. Nga KZAZ-të e monitoruara më datë 21.04.2021 rezulton se në KZAZ nr. 35, Tiranë nuk janë ngritur GNV-të.

---

<sup>1</sup> [https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2021/04/Raport-Paraprak-per-Procesin-Parazgjedhor\\_Monitorimi-KShH\\_23-Prill-2021.pdf](https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2021/04/Raport-Paraprak-per-Procesin-Parazgjedhor_Monitorimi-KShH_23-Prill-2021.pdf)



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Edhe në Vlorë ka patur raste ku GNV-të nuk janë ngritur, konkretisht në KZAZ nr. 84 dhe nr. 86, ku shkak është bërë konflikti politik mes subjekteve LSI dhe PDIU, sa i takon emërimin të numëruesit të katërt në përputhje me nenin 96 të KZ. Procesi është shoqëruar edhe me vonesa, ku ndër KZAZ-të e monitoruara, KZAZ nr. 83 në Vlorë, KZAZ nr. 66 në Berat dhe KZAZ nr.81 në Gjirokastrë janë ngritur përkatësisht një deri në 5 ditë në tëjkalim të afatit ligjor<sup>2</sup>.

Përcjellja me vonesë e propozimeve të emërimit të anëtarëve të GNV-ve nga subjektet zgjedhore, ka sjellë vonesa duke sjellë krijimin e grupeve me përbërje të pjesshme<sup>3</sup>. Kështu, në KZAZ nr.81 në Gjirokastrë, propozimet për anëtarë janë përcjellë pesë ditë me vonesë. Koordinatorët lokalë raportojnë se nëtarët e emëruar kanë arsim të lartë.

Gjatë monitorimit të GNV-ve, për vëzhguesit e KShH-së ka patur kufizim aksesi në KZAZ nr 35, Tiranë dhe KZAZ nr.48 dhe 50 në Elbasan, anëtarët e të cilave nuk kanë lejuar vëzhguesit të kqyrnin Librin e Protokollit apo vendimet e KZAZ, në cënim të nenit 7 të Kodit Zgjedhor (KZ) .

## 1. Heshtja Zgjedhore

Nga monitorimi i KZAZ-ve realizuar më datë 24 prill 2021, u vu re se heshtja zgjedhore është respektuar pjesërisht në Bashkitë e monitoruara. Shkelje të parashikimit të nenit 77 të KZ për heshtjen zgjedhore janë evidentuar në disa Bashki, përkatësisht në Dibër<sup>4</sup>, Elbasan, Vlorë, Pogradec, Tiranë ku është vërejtur shpërndarja e fletushkave, posterave dhe materialeve propagandistike pothuaj kudo në qytet, në institucione publike dhe private; si dhe zyrat elektorale të cilat kanë vijuar të jenë të ngritura. Nga ana tjetër, raportohet se medial lokale kanë respektuar plotësisht parashikimet e nenit 77 të KZ për heshtjen zgjedhore.

Ndërkohë nuk ka asnjë vendim nga KQZ për gjobitjen e subjekteve të cilët kanë thyer heshtjen zgjedhore, në zbatim të nenit 174 të KZ.

Gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, vëzhguesit e KShH-së kanë testuar opinionin publik ku kanë takuar qytetarë në rrugë, për të dëgjuar vlerësimet e tyre për klimën me të cilën janë shoqëruar zgjedhjet parlamentare 2021, kryesisht në Bashkitë Dibër, Pogradec, Malësi e Madhe, Berat dhe Lezhë. Nga rezultati i këtyre intervistave evidentohet se shumica e qytetarëve se do të marrin pjesë në ditën e votimit. Gjithashtu rreth 15% e personave (edhe pse ky kampion nuk është gjithëpërfshirës) kanë pohuar se atyre ose të afërmve të tyre u janë premtuar të mira materiale në këmbim të votës, si dhe janë intimiduar për votimin e një partie/kandidati të caktuar. Më tej, shqetësuese mbetet numri i lartë i personave të cilët kanë shprehur besimin se zgjedhjet do të shoqëroreshin me incidente (rreth 60%). Fatmirësisht, një gjë e tillë ka qënë e minimizuar gjatë ditës së votimit.

## 2. Shpërndarja e materialeve zgjedhore

<sup>2</sup> Në KZAZ 83 Vlorë, vendimmarrja për ngritjen e GNV-ve është kryer më 19.04.2021, ndërsa në KZAZ nr. 66 në Berat vendimi është marrë më datë 16.04.2021

<sup>3</sup> GNV-të janë ngritur me përbërje prej 4 anëtarë, ku në pjesën më të madhe të KZAZ-ve të monitoruara janë respektuar parashikimet e nenit 95 dhe 96 mbi përkatësinë politike të anëtarëve, me përjashtim të KZAZ nr. 84 dhe 86 në Vlorë,

<sup>4</sup> Kadidati për deputet Xh. Mziu ka reaguar në mediat sociale (më datë 24 prill) ndaj akuzave të kundërshtarëve politike "lidhur me deklaratën e tij, për të cilën është proceduar penalisht nga Prokuroria e Rrethit Dibër"



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Kodi Zgjedhor parashikon se KQZ-ja dërgon materialet zgjedhore në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve. Nga monitorimi i realizuar evidentohet se ky afat është respektuar nga KQZ për KZAZ-të në Bashkitë e monitoruara. Dërgimi i kamerave dhe Pajisjeve Elektronike të Identifikimit (PEI) është realizuar veçmas nga materialet e tjera, për shkak të veçorive të transportimit dhe instalimit, sipas udhëzimeve të veçanta të KQZ-së.

Neni 100 i KZ parashikon një afat 15 orë para hapjes së votimit për dërgimin e materialeve nga KZAZ-të përkatëse drejt KQV-ve nën juridiksionin e saj, afat i cili përkon me orën 16.00 të datës 24 prill. Ky afat për një pjesë të madhe të KZAZ-ve nuk është respektuar.<sup>5</sup> Vonesat në përcjelljen e materialeve kanë qënë mes 1-5 orëve nga afati. Shkak është bërë kryesisht mungesa e koordinimit efektiv mes anëtarëve të KZAZ-ve, ndryshimet që ka pësuar anëtarësia e tyre, vonesat në emërimin dhe zëvendësimin e komisionerëve etj<sup>6</sup>.

Shpërndarja e materialeve zgjedhore në disa raste, në KZAZ nr.35 në Tiranë, KZAZ nr.1 në Malësinë e Madhe dhe KZAZ nr.65 dhe 66 në Berat, është bërë me anë të mjeteve private të anëtarëve të KQV, pa shenja dalluese si logot përkatëse<sup>7</sup>, si dhe duke mos u shoqëruar me punonjësit e policisë, të cilët kanë qënë të pranishëm vetëm në QV gjatë marrjes në dorëzim të materialeve. Të gjitha QV-të e monitoruara ruhen nga punonjës të Policisë së Shtetit. Monitorimi i vëzhguesve në Gjirokastrë është kufizuar nga efektivët e policisë, në kundërshtim me nenin 7 të KZ, me pretendimin se në kohën e monitorimit nuk ishte mbyllur procesi i përgatitjes së QV-ve përkatëse<sup>8</sup>. Kufizim është evidentuar edhe në Nën KZAZ nr. 40 në Tiranë ku u refuzua marrja e informacionit, me pretendimin se anëtarët ishin shumë të zënë me punë ndërsa në KZAZ nr. 34 Tiranë u pengua prania e vëzhguesve dhe u refuzua dhënia e informacionit.

Gjatë procesit të shpërndarjes nuk janë respektuar masat dhe rregullat anti-Covid, kryesisht për mbajtjen e maskës apo distancës. Gjatë marrjes së materialeve nga ana e KZAZ, vërehet si problematikë mungesa e prezencës së operatorëve për marrjen në dorëzim të kamerave, veçanërisht në KZAZ-të e monitoruara në Bashkinë Dibër dhe Lezhë.

### 3. Votimi

#### a) Klima e përgjithshme dhe Rendi Publik

Gjatë procesit të votimit, situata raportohet të ketë qënë e qetë dhe pa incidente, në ndryshim nga klima parazgjedhore e cila ka patur një trend ashpërsues para datës së heshtjes zgjedhore.

Policia e shtetit, nga monitorimi i medias por dhe vëzhguesve, rezulton ta ketë menaxhuar me vigjilencën dhe vëmendjen e duhur situatën e rendit dhe sigurisë publike si dhe respektimin e

---

<sup>5</sup> Konkretisht, shpërndarja nga KZAZ nr. 12 dhe nr. 13 në Lezhë pranë KQV-ve përkatëse ka përfunduar rreth orës 17.00-17.45, KZAZ nr. 1 në Malësinë e Madhe ka përfunduar procesin në orën 18.00, KZAZ nr 69 në Pogradec ka vijuar shpërndarjen deri në orët e vona të datës, në Elbasan KZAZ-të nr 47, 48, 49 dhe 50 kanë vijuar procesin e shpërndarjes deri në orën 20.30, në KZAZ nr.4 në Shkodër, në orën 19.30 të datës 24 prill nuk ishin shpërndarë materialet zgjedhore për të paktën dy qendra zgjedhore, në KZAZ nr 31 në Tiranë shpërndarja do të fillonte pas orës 15.00, ccka e bën të vështirë respektimin e afatit ligjor.

<sup>6</sup> Praktika për shpërndarjen e materialeve nga KQV ka qënë fillimisht duke furnizuar QV të cilat ndodhen larg, kryesisht nëpër fshatra, me pas ato që ndodhen në qendrat urbane.

<sup>7</sup> Edhe pse anëtarët kanë pohuar verbalisht se automjetet kanë qënë të autorizuar

<sup>8</sup> QV 4254, QV 42541, QV42542 dhe QV 4248



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

detyrave që janë parashikuar në Kodin Zgjedhor, dhe në mënyrë të veçantë në rastet kur KQV-të kanë kërkuar ndihmesën e saj, në kushtet kur në qendrën e votimit mund të jetë siguruar rendi ose zhvillimi i rregullt i votimit. Gjith, vërehet si pozitiv fakti se thirrja e efektivëve të policisë së shtetit është bërë vetëm në raste përjashtimore dhe është aplikuar si masë e fundit, tregues pozitiv ky i menaxhimit të situatës nga vetë KQV-të kur ka patur tentativa për të bllokuar procesin e votimit, reagime emocionale të vëzhguesve partiakë, etj.

## **b) Ndërgjegjësimi i zgjedhësve dhe pjesëmarrja në votime**

Një nga objektivat kryesorë të nismës së ndërmarrë nga KShH konsistonte në adresimin e nivelit të mosbesimit të qytetarëve shqiptarë duke nxitur një angazhim më të afërt dhe të rregullt të tyre në proceset politike të lidhura me ushtrimin e të drejtës së votës. Në bashkëpunim me Civil Rights Defenders, Institutin për Studime Politike dhe 4 organizata aktive lokale në Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe Durrës, janë kryer një sërë aktiviteteve ndërgjegjëse që kanë kontribuar modestisht në pjesëmarrjen e lartë të zgjedhësve në Zgjedhjet Parlamentare të dt.25 Prill.

KShH shikon si një aspekt shumë të rëndësishëm, pjesëmarrjen e konsiderueshme të zgjedhësve në rang vendi, në masën 47,94 %, sipas të dhënave të raportuara nga KQZ. Shifrat e raportuara për pjesëmarrjen janë një tregues pozitiv, në drejtim të rritjes së besimit të zgjedhësve tek e drejta për të votuar dhe institucioni demokratik i zgjedhjeve.

## **c) Aksesi i vëzhguesve të KShH-së në vëzhgim**

KShH ka angazhuar në total 206 vëzhgues, prej të cilëve 185 vëzhgues kanë monitoruar 424 Qendra Votimi.

Në përgjithësi, aksesit i vëzhguesve në QV-të e monitoruara ka qenë i plotë dhe pa pengesa. Vëzhguesit e KShH-së kanë patur një rol pro-aktiv në paraqitjen e vërejtjeve me shkrim drejtuar Komisioneve të Qendrave të votimit dhe në disa raste, këto vërejtje i kanë shërbyer pozitivisht parandalimit të disa parregullsive të evidentara në vijim, përgjatë procesit të votimit.

Me keqardhje kemi vërejtur se në raste të caktuara, vërejtjet e tyre me shkrim nuk janë protokolluar nga KQV, me argumenta të pabazuar apo ka patur raste sporadike të intimidimit dhe presionit ndaj vëzhguesve të KShH-së. Në QV 0316/1 Shkodër, ndaj vëzhgueses është ushtruar intimidim dhe është kërkuar të largohej. Në QV 3026, Bashkia Fier, anëtari i KQV-së kërkoi nga vëzhguesi mos-raportimin e problemeve lidhur me fotografimin e votës. Në QV 2374/1, anëtari i KQV-së kundërshtoi mbajtjen e proces-verbalit për vërejtjen me shkrim të vëzhguesit të KShH-së.

## **d) Angazhimi i Komisionit Qendor të Zgjedhjeve**

KShH vëren se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në cilësinë e përfaqësuesit të KQZ-së, ka patur një rol pro-aktiv gjatë ditës së votimit, duke informuar në mënyrë të vzhdueshme median dhe publikun. Që në orët e para të mëngjesit, Komisioneri ka sjellë në vëmendje të subjekteve zgjedhore, përfaqësuesve të administratës publike dhe publikut të gjerë, detyrimin për respektimin e heshtjes zgjedhore. Në mbyllje të procesit të votimit, KQZ i ka kujtuar subjekteve që të mos nxitojnë në shpalljen e rezultateve dhe të tregojnë respekt ndaj organeve të administratës zgjedhore që janë përgjegjëse për këtë proces. Gjithashtu, Komisioneri ka realizuar



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

disa dalje publike lidhur me momentet kyç të administrimit të procesit të votimit, përfshi këtu edhe sqarimin e opinionit publik se në cilat QV janë ndeshur probleme me PIE-të dhe si ka funksionuar votimi në këto QV. Pozitiv është fakti që faqja zyrtare e KQZ-së ka mundësuar akses në kohë reale të informacionit lidhur me pjesëmarrjen e votuesve dhe rezultatet e numërimit të votave.

KShH në orët e para të mesditës ka vendosur në dijëni KQZ-në për disa nga parregullsitë e procesit të monitorimit të votimit. Në fakt, KQZ evidenton nevojën për një strukturë të shtuar për të patur komunikim efektiv me vëzhguesit e OJF-ve, gjith shpresojmë që konkluzionet e paraqitura të kenë ardhur në ndihmë të KQZ-së për orientimin e nevojshëm ndaj KZAZ-ve dhe KQV-ve.

### *e) Hapja e votimit*

Nga 14 Bashkitë objekt monitorimi konstatohet se në pjesën më të madhe të Qendrave të Votimit (QV) nuk ka patur vonesa të konsiderueshme në hapjen e procesit të votimit. Janë evidentuar vonesa 20-35 min, ku shkak është bërë mungesa e energjisë elektrike,<sup>9</sup> probleme teknike të funksionimit të pajisjes PEI (identifikimi elektronik)<sup>10</sup>, mungesa e efikasitetit të trajnimit mbi përdorimin e kësaj pajisjeje<sup>11</sup>, vonesat/mungesat e anëtarëve<sup>12</sup> dhe operatorëve<sup>13</sup>, vonesa në përgatitjen e ambientit, mosfunksionimi i kamerave etj. Në fillim të ditës së votimit janë raportuar raste ku anëtarët e KQV nuk i kryejnë veprimet sipas rradhës së caktuar, duke lejuar zgjedhësit të ushtrojnë të drejtën e votës përpara se të timbroset<sup>14</sup>. Vonesa në veprimtarinë e QV-ve kanë shkaktuar edhe shkarkimet/zëvendësimet e anëtarëve që në orët e para të mëngjesit<sup>15</sup>. Ndryshimi i disa QV në Bashkinë Lezhë, si pasojë e dëmtimeve nga tërmeti e ambienteve të përcaktuara si QV ka krijuar çorientim tek zgjedhësit<sup>16</sup>. Më herët KShH ka përcjellë këtë shqetësim pranë KQZ-së.<sup>17</sup>

### *f) Masat Anti-Covid*

Protokolli “Lidhur me masat anti-Covid19 gjatë procesit zgjedhor dhe ditën e votimit”<sup>18</sup> nuk është zbatuar rigorozisht në QV-të e monitoruara. Veçanërisht është konstatuar se jo të gjitha QV të janë vendosur në katin e I-rë të ndërtesës, nuk kanë patur dyert apo dritaret e nevojshme që garantojnë ajrosje të mjaftueshme, konform masave për ndalimin e përhapjes së Covid-19. Gjithashtu, vëzhguesit kanë sinjalizuar rregullisht se masat ndaj Covid-19 (mbajtja e maskës,

<sup>9</sup> QV 3269 e Bashkisë Berat votimi ka filluar rreth gjysëm ore me vonesë për këtë shkak e

<sup>10</sup> QV 32871 (Bashkia Berat), QV 0735 (Bashkia Berat), QV 3889 (Bashkia Pogradec), QV 3907/1 dhe 3907 (Bashkia Pogradec), QV 1411 (Bashkia Durrës), QV 14113 (Bashkia Durrës), QV 1429/2 (Bashkia Durrës), QV 4447 (Bashkia Vlorë)

<sup>11</sup> QV 3889 (Bashkia Pogradec)

<sup>12</sup> QV 3908 (Bashkia Pogradec), QV 3907 (Bashkia Pogradec), QV 0712/1, 0731 dhe 0742 (Bashkia Lezhë)

<sup>13</sup> QV 1381 (Bashkia Durrës)

<sup>14</sup> QV 3669 (Bashkia Fier) QV 3653 (Bashkia Korçë)

<sup>15</sup> Në QV nr. 2307 (Bashkia Elbasan) dhe QV 4258 (Bashkia Gjirokastrë), u zëvendësua një anëtar i KQV-së, me vendim të KZAZ. Në QV 0254/1 (Bashkia Shkodër) është shkarkuar një anëtar i KQV dhe zëvendësuar pas një ore.

<sup>16</sup> QV nr. 07121 dhe 07091 (Bashkia Lezhë)

<sup>17</sup> Shkresë nr. 284 prot., dt. 09.04.2021.

<sup>18</sup> Miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Udhëzim nr. 11 dt. 24.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

distancimi) nuk zbatohen në mënyrë të përgjegjshme dhe rigoroze si nga anëtarët e KQV-së dhe zgjedhësit.

## **g) Infrastruktura elektronike zgjedhore**

KShH vëren se pavarësisht masave të marra nga KQZ për ngritjen dhe funksionimin e infrastrukturës elektronike zgjedhore, ky proces ka diktuar nevojën për tu menaxhuar më herët në kohë, ndërkohë që kostoja ekonomike ka qenë e konsiderueshme.

Përdorimi i sistemit PEI në këtë proces zgjedhor mendojmë se i ka gjetur të papërgatitur anëtarët e KQV-ve. Vonesat më të mëdha janë shkaktuar nga mosfunksionimi i këtij sistemi në disa prej QV-ve të Bashkive të monitoruara, çka ka shkaktuar pezullim të procesit, rradhë mes votuesve, si dhe kthimin e procesit manual të identifikimit të zgjedhësve<sup>19</sup>. Si rrjedhojë e aplikimit të identifikimit elektronik ose biometrik të zgjedhësve, KQV-të vërehet të mos kenë ndjekur një praktikë të unifikuar për respektimin e procedurave të detyrueshme të votimit të parashikuar në nenin 105 të Kodit Zgjedhor, si heqja e vizës emrit të zgjedhësve në listën e zgjedhësve apo nënshkrimi i zgjedhësit përbri emrit në listë<sup>20</sup>. Gjithashtu, është vërejtur se në disa QV zgjedhësit nuk janë timbrosur apo nuk janë kontrolluar paraprakisht nëse janë timbrosur, përpara se t'i jepej fleta e votimit. Nga anëtarët e QV-ve kjo është justifikuar në mënyrë të pabazuar se këto procedura nuk do të realizoheshin më për shkak të digjitalizimit të procesit.

Në vlerësimin e KShH-së, KQZ duhet të kishte marrë masa për të udhëzuar paraprakisht në kohë QV-të në përballimin e situatës, në rast mosfunksionimi të pajisjes PEI. Pavarësisht se KQZ deklaroi se kishte një plan B, në momentin e ndërhyrjeve të padrejta në sistemin e krijuar nga ky institucion, nga vëzhgimet në terren u vërejt se QV nuk kishin parashikuar asnjë plan të tillë si dhe tek anëtarët e KQV-ve u vërejt konfuzion.

Rast flagrant është raportuar nga ana e vëzhguesit në QV nr. 3889/1 në Bashkinë Pogradec, në të cilën u konstatua se pajisja PEI e përdorur nga ana e operatorit reflektonte të dhëna edhe në telefonin celular të vëzhguesit të një subjekti politik.

Pajisja PEI në mënyrë të përsëritur e ka bërë të pamundur leximin e gishtërinjve të votuesve, kryesisht moshuarve, duke krijuar disa pengesa për ta, por që janë zgjidhur nëpërmjet procedurave manuale që i kanë garantuar këtyre zgjedhësve të drejtën e votës.<sup>21</sup>

## **h) Prezenca e personave të paautorizuar në ambientet brenda dhe jashtë QV**

Me ndryshimet që pësoi neni 109 KZ, me shtimin e pikave 6 dhe 7 konstatohet se prezenca e personave të paautorizuar nuk lejohet jo vetëm në ambientet e brendshme të QV, por edhe jashtë saj.

<sup>19</sup> Në QV 1411, 14113, 1429/2 (Bashkia Durrës)

<sup>20</sup> Problematika të evidentuara në: QV 1498, 1460 (Bashkia Durrës), QV 0274, 0260 (Bashkia Shkoder), QV 1767, 2002, 1767, 1804 (Bashkia Tiranë), QV 4507/1 (Bashkia Vlorë), QV 0260 (Bashkia Shkodër) dhe masivisht në QV në Bashkinë Berat QV 39201, QV 3291, QV 3292, QV 3279, QV 3280 dhe QV 3281/1.

<sup>21</sup> QV 3891/2 (Bashkia Pogradec) QV 0734 (Bashkia Lezhë), QV 1460, (Bashkia Durrës)



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Përgjatë procesit të votimit, vëzhguesit e KShH-në kanë raportuar vazhdimisht për prezencën e personave të paautorizuar, të cilët orientojnë apo shoqërojnë zgjedhësit për në QV-të.<sup>22</sup> Është problematik fakti që anëtarët e KQV-së rrallëherë kanë marrë masa për largimin e personave të paautorizuar nga ambientet e QV-së, nëpërmjet njoftimit të oficerëve të policisë me pretendimin se janë përgjegjës vetëm për rregullin brenda QV, në kundërshtim me pikën 6 dhe 7 të nenit 109 KZ.

Gjithashtu, në ambientet brenda disa prej QV në Bashkitë Lezhë<sup>23</sup>, Berat,<sup>24</sup> Pogradec<sup>25</sup>, Dibër<sup>26</sup> dhe Malësi e Madhe<sup>27</sup>, Tiranë dhe Shkodër<sup>28</sup> është konstatuar prezencë e personave të autorizuar nga KQZ, si vëzhgues të subjekteve politike të cilët shoqërojnë votuesit në dhomën e fshehtë ose mbajnë shënim emrat e zgjedhësve në momentin kur lexohen nga ana e anëtarëve të QV, apo e numrit rendor të votuesit<sup>29</sup>.

Përdorimi i bexhave në format të printuar dhe jo sipas modelit të miratuar nga ana e KQZ-së është vërejtur në rastin e vëzhguesve të subjekteve politike, bexhat e të cilëve janë nënshkruar nga kryetari i KZAZ.<sup>30</sup> Prezenca e punonjësve të Policisë së Shtetit është vërejtur në ambientet e jashtme të QV, gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit të votimit, por në asnjë rast nuk janë evidentuar incidente.

## *i) Votimi familjar*

Përsa i përket ndalimit të votimit familjar, vëzhguesit e KShH kanë evidentuar se anëtarët e Komisioneve kanë qenë të paqartë dhe jo të orientuar mjaftueshëm për procedurat dhe kanë referuar në mënyrë të gabuar në disa raste, nenin 108 të KZ që parashikon votimin me ndihmës (asistues) për zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Kështu, gjatë vëzhgimit janë raportuar vazhdimisht raste të votimit të anëtarëve të familjes bashkarisht<sup>31</sup>. Administrata zgjedhore në disa raste ka reaguar vetë për moslejimin e votimit familjar në mënyrë të përsëritur<sup>32</sup>, si dhe në disa raste tentativat për votim familjar janë parandaluar nga depozitimi i vërejtjes me shkrim nga vëzhguesit e KShH. Problematike është raportuar refuzimi i marrjes në dorëzim dhe protokollimit të vërejtjeve me shkrim për votim familjar prej anëtarëve të QV 1157 dhe 1144 (Bashkia Dibër), në shkelje të nenit 7 të KZ.

## *j) Procedurat për gjedhësit që nuk mund të votojnë vetë*

<sup>22</sup> QV 255/1, 259 (Bashkia Shkodër), QV 1844 (Bashkia Tiranë), QV 3026/1 (Bashkia Fier), QV 43131 (Bashkia Gjirokastër).

<sup>23</sup> QV 07341 (Bashkia Lezhë)

<sup>24</sup> QV 3291/1 dhe QV 3295 (Bashkia Berat).

<sup>25</sup> QV 3889/1 (Bashkia Pogradec)

<sup>26</sup> QV 11431 (Bashkia Dibër)

<sup>27</sup> QV 0493 (Bashkia Malësi e Madhe)

<sup>28</sup> QV 1767/1, 1856, 1728 Bashkia Tiranë, QV 0250, 260 Bashkia Shkodër

<sup>29</sup> QV 4238 (Bashkia Gjirokastër)

<sup>30</sup> QV 07121 dhe 07091 (Bashkia Lezhë)

<sup>31</sup> QV 3889 dhe 3908 (Bashkia Pogradec) dhe QV 1143, 1149, 1144, 1157 (Bashkia Dibër), QV 1411/2, 1489/1, 1449/2, (Bashkia Durrës), QV 4235 (Bashkia Gjirokastër), QV 1724 (Bashkia Tiranë), QV 364/1 (Bashkia Korçë), QV 0255/1, 260 (Bashkia Shkodër)

<sup>32</sup> QV 361 (Bashkia Korçë)



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Në të gjitha Bashkitë, janë raportuar raste të ofrimit të mbështetjes për të ushtruar të drejtën e votës ndaj personave të cilët, për arsye fizike, nuk kanë qenë në gjendje të votojnë vetë. Përgjithësisht, në të tilla situata, anëtarët e KQV-ve kanë vepruar në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 108. Megjithatë, janë raportuar raste ku KQV ka lejuar ofrimin e asistencës nga një person që nuk është pjesë e listës zgjedhore ku është regjistruar personi që po asiston, ka lejuar që një person të ofrojë asistencë ndaj më shumë se një personi apo nuk është dokumentuar në librin e protokollit e zgjedhësit që ofruar ndihmën. Në disa raste, në mungesë fizike të këtyre deklaratave është mbajtur procesverbali përkatës.

### ***k) Fshehtësia e votës***

Janë evidentuar raste ku zgjedhësit kanë shkelur parimin e fshehtësisë së votës duke zbuluar votën e tyre gjatë palosjes së votës apo e kanë komunikuar atë me zë të lartë<sup>33</sup>. Gjithashtu vëmendje të shtuar në raportimin e vëzhguesve ka patur edhe fotografimi i votës, i cili ngarkon me përgjegjësi penale zgjedhësit në bazë të nenit 327 K.Penal. Ndalimi i përdorimit të telefonisë celulare për zgjedhësit ka qenë në vëmendje të KQZ, ndërkohë që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve gjatë ditës së fillimit të heshtjes zgjedhore ka ofruar për publikun porositë e tij.<sup>34</sup>

KShH është sinjalizuar për përdorim të telefonisë celulare dhe tentativave për fotografim të votës disa qendra votimi në Pogradec, Dibër, Tiranë, Fier, Vlorë.<sup>35</sup> Në këto raste, praktika e ndjekur nuk ka qenë e unifikuar, shtetasit janë këshilluar verbalisht ose anëtarët e KQV-së kanë sekuestruar telefonin përkatës. Jo në të gjitha rastet e fotografimit, fletët e votimit janë vlerësuar si të pavlefshme dhe votuesve u është dhënë një tjetër fletë votimi. Ndërhyrja e Policisë është kërkuar në raste të rralla, në Bashkinë Tiranë (QV1767) dhe Vlorë (QV 4498/1), ku pas vërejtjeve të vëzhgueses së subjekteve zgjedhor pas oficerët e policisë morën të dhënat e personit dhe kërkuan procesverbalin e mbajtur nga Kryetarja e KQV në cilësinë e provës.

### ***l) Procesi i votimit pranë Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale***

Objekt i monitorimit të KShH-së kanë qenë dhe QV të posaçme të ngritura në katër Institucione të Ekzekutimit të vendimeve Penale (Burgje), përkatësisht në Shën Koll, Reç (Malësi e Madhe), Durrës dhe Drenovë (Korçë). Pjesëmarrja e shetasve të privuar nga liria në terma statistikore mbetet për tu vlerësuar në një moment të mëvonshëm, megjithë tërheq vëmendjen fakti se në IEVP Reç ku janë 373 shtetas me të drejtë vote, deri në orën 13:20 rezultojnë të kenë votuar 56 të paraburgosur (rreth 15%).

Në QV në IEVP Shënkoll është referuar se votimi është hapur në orën 07.00, ndërsa në IEVP Rec dhe Durrës ka patur vonesa për shkak të mospërgatitjes në kohë të materialeve zgjedhore dhe QV-së. Në këto QV është konstatuar gjendje e qetë, pa incidente dhe pa prezencë të përfaqësuesve të Policisë së Burgjeve në ambientet e brendshme të QV. Nuk raportohen raste dukshme të intimidimit apo influencimit tek shtetasit e privuar nga liria, me qëllim ndikimin mbi vullnetin e shtetasve të privuar nga liria.

<sup>33</sup> QV 3636/1, 3660, 4510 Bashkia Korçë, QV 2374 Bashkia Elbasan, QV 2355 Bashkia Durrës

<sup>34</sup> <http://ëëë.panorama.com.al/mos-u-paraqitni-me-telefona-ne-qendrat-e-votimit-kreu-i-kqz-paralajmeron-votuesit-do-konsiderohet-tentative-per/>

<sup>35</sup> QV 3889 dhe 3891/2 (Bashkia Pogradec), QV 1157 (Bashkia Dibër), QV 1845/3, (Bashkia Tiranë), QV 4498/1 (Bashkia Vlorë).





# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Për të dyja QV të vendosura në IEVP-të Rec dhe Malësi e Madhe është vërejtur se 20 të paraburgosur janë paraqitur me vendim gjyqësor për të votuar (për shkak të pasaktësive apo mangësive në listat e zgjedhësve). Gjatë procesit, në IEVP Durrës është bërë vërejtje me shkrim nga vëzhguesit lidhur me mos-regjistrimin e numrit të ID-së. Në një pjesë të rasteve është vërejtur se të burgosurit nuk kanë patur informacion për rregullat e reja të mënyrën e votimit.

## ***m) Mbyllja e procesit të votimit***

Në shumicën dërrmuese të QV-ve, procesi i votimit është mbyllur brenda afatit kohor të parashikuar në Kodin Zgjedhor, në orën 19:00. Në disa QV, është raportuar ky afat kohor nuk është respektuar nga ana e KQV-ve (në kushtet kur ka patur ose jo zgjedhës në radhë ose për ti mundësuar anëtarëve të KQV-ve të votojnë), ndërkohë që vonesat e konstatuara kanë qenë maksimalisht 1 orë si rezultat i mbylljes së votimit<sup>36</sup>.

Mbyllja e votimit referohet nga ana e vëzhguesve se është realizuar në respektim të procedurave të parashikuara në nenet 113 e vijues të KZ, përveç ndonjë rasti si në QV 2002, Bashkia Tiranë, ku është evidentuar se ka patur mospërputhje midis numrit të zgjedhësve që kanë votuar dhe fletët e votimit të përdorura. Mjetet e transportit me anë të të cilave janë përcjellë kutitë e votimit janë shoqëruar me prezencën e punjonjësit të Policisë së Shtetit, sekretarit dhe anëtarit të KQV. Vetëm në QV 3890 (Bashkia Pogradec) u vërejt dëmtim i kutisë së votimit, dyllosja e të cilës është realizuar nga kryetari i KZAZ.

## **4. Numërimi i votave**

Në vijim të mbylljes së procesit të votimit për Zgjedhjet për Kuvend të 25 prillit 2021, KShH monitoroi 21 Vënde të Numërimit të Votave (VNV) në 14 Bashki. Parashikimi ligjor i nenit 114 të KZ për mbërritjen pranë VNV-ve, të kutive të votimit të të gjitha QV-ve në juridiksionin e ZAZ-së, brenda 3 orësh prej mbylljes së votimit, përgjithësisht nuk u zbatua. Përjashtim bën ZAZ nr. 11 Bashkia Kukës, ZAZ nr. 59 Bashkia Fier, ZAZ nr 73 Bashkia Korçë, të cilat përfunduan procesin e dorëzimit të kutive të votimit brenda afatit kohor të parashikuar në dispozitën ligjore.

Ashtu si në të kaluarën, KShH vëren se administrata zgjedhore e ngarkuar për numërimin e votave trajnohet në një kohë të papërshtatshme, vetëm pak kohë para se të fillojë procesi i numërimit, duke krijuar premisa për mosnjohjen e duhur të legjislacionit zgjedhor. Gjithashtu, trajnimi para numërimit dhe fakti që GNV-të punojnë me orare të zgjatura veçanërisht gjatë orëve të natës, krijojnë probleme në drejtim të ritmit të procesit të numërimit dhe përqëndrimit të anëtarëve të GNV-ve.

Konkretisht, për të gjitha Bashkitë vërehet se rreth 1 orë përpara fillimit të numërimit, është realizuar trajnimi i anëtarëve të GNV-ve, në formë të përsheptuar, çka vendos në pikëpyetje cilësinë dhe efikasitetin e trajnimeve. Kjo ka reflektuar në disa raste, në paqartësi dhe konfuzion te anëtarët e GNV sidomos për kategorimin e një vote si të pavlefshme (ZAZ 69 dhe 79

<sup>36</sup> QV 3016 Bashkia Fier (19.50); QV 260 (20.03), QV 259/1 (19.40), QV 259 (19.36) Bashkia Shkodër, QV 4440 Bashkia Vlorë (19.35), QV 0633 (20.01), QV 0648, QV 0649 (19.47) Bashkia Kukës



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Pogradec). Problematikë është paraqitur në ZAZ nr.48 në Elbasan ku nuk ishin bërë emërimet e anëtarëve të GNV deri në momentin e dorëzimit të kutive në shkelje të nenit 95 të KZ.

Ndër VNV-të e monitoruara në 14 Bashkitë respektive, ZAZ nr. 18 në Bashkinë Dibër është e para që ka filluar procesin e numërimit në orën 00:00. Ndërkohë numërimi ka nisur me vonesë të konsiderueshme në ZAZ nr. 21 dhe nr. 24, Bashkia Durrës (respektivisht në 03:23 dhe 03:55).

Procesi i numërimit ka filluar me ritme normale por më pas është ngadalësuar, për shkak të lodhjes së komisionerëve. Kështu, në ZAZ nr. 73 në Bashkinë Korçë numërohet vetëm 1 kuti në 1 orë. Gjithashtu ka patur raste të ndërprerjes së procesit me intervale të shkurtra kohore, ndërsa ZAZ nr.39 në Bashkinë Tiranë numërimi është pezulluar për të rifilluar në orën 13.00, çka në vlerësimin e KShH-së përbën një kohë relativisht të gjatë pushimi që ngadalëson procesin e numërimit.

Vërehet një prezencë e madhe e vëzhguesve të akredituar të subjekteve politike, të cilët kanë depozituar edhe vërejtje ndaj GNV. Vlen të theksohet fakti se VNV-të janë tepër të populluara dhe Protokollin e masave ndaj pandemisë Covid-19 nuk zbatohet rigorozisht. Vëzhguesit e KShH-së raportojnë kryesisht se fletët e votimit kalojnë shumë shpejt në monitor, çka pamundëson një akses pamor me vëmendjen e duhur nga vëzhguesit që janë të pranishëm. Mgjith, pavarësisht kalimit të shpejtë në monitor, ekspozimi në drejtim të qartësisë së figurës është në nivele të kënaqshme.